



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE  
DEKANI

Nr. 1241/15 Prot.

Tiranë, më 26.10.2020

VENDIM

Nr. 10 Datë 26.10.2020

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PUNËSIMIT TË PERSONELIT  
AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME SI DHE TË PËRCAKTIMIT TË  
NEVOJAVE PËR SECILIN DEPARTAMENT**

Në zbatim të Urdhrit të Rektorit Nr.98 datë 07.10.2020 "Për punësimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2020 – 2021 në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2019 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë", mbështetur në planifikimet e shpërndarjes së ngarkesës mësimore për pedagogët me kohë të plotë si dhe përcaktimin e nevojave për personel akademik me kohë të pjesshme nga departamentet përcjellë me shkresat nr. 1241/2 prot, datë 23.10.2020 nr.1241/3 prot, datë 26.10.2020 nr.1241/4 prot datë 26.10.2020 të DLKIPISBP, DDRSHIKIOGJ, dhe DLPK)

**Dekani vendosi:**

**Të miratojë kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme si më poshtë:**

**KRITERET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË  
PJESSHME DEPARTAMENTI I LËNDËVE PARAKLINIKE**

- I. Kandidatët për vendet e punës për personel akademik me kohë të pjesshme në DLPK duhet të plotësojnë këto kriteret të përgjithshme:
1. Të jenë diplomuar në programe të integruara ose "Master i Shkencave" në fushën përkatëse. Për diplomat e fituara në Universitetet e huaja, duhet të jetë bërë njohja nga organi kompetent;
  2. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar;

Adresa: Rr. e Dibrës, brënda QSU "Nënë Tereza", Tiranë. website:www.fshmt.umt.rash.al;



3. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata
4. Të zotërojnë me dëshmi të paktën një nga 5 gjuhët e huaja të Bashkimit Europian(anglisht, frëngjisht,,gjermanisht, italisht, spanjisht);

### **Kritere specifike**

1. Të kenë përfunduar studimet në programin e integruar të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” me notë mesatare mbi 8. Nëse nuk ka paraqitje Brenda afatit të aplikantëve me këtë mesatare atëherë mund të pranohen aplikantë me mesatare më të ulët, pas miratimit paraprak nga Departamenti përkatës.
2. Të ketë nivel të njohjes së gjuhës së huaj, preferohet gjuha angleze.
3. Të ketë licencën për ushtrimin individual të profesionit, të lëshuar nga Urdhri i Mjekëve.

### **Kritere preferenciale**

1. Preferohen kandidatë që kanë eksperiencë mësimdhënie në fushën përkatëse pranë IAL-ve në vend ose të huaja dhe që kanë marrë pjesë në veprimtari kërkimore dhe/ose aktivitete shkencore në fushën e shkencave të shëndetit

## **KRITERET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHME DEPARTAMENTI I LËNDËVE KLINIKE (DLKIPISBP)**

Kandidatët për vendet e punës për personel akademik me kohë të pjesshme në DLK duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në programet e integruara ose Master i Shkencave, në degët përkatëse
2. Të ketë përfunduar studimet universitare me notë mesatare mbi 8. Nëse nuk ka paraqitje Brenda afatit të aplikantëve me këtë mesatare atëherë mund të pranohen aplikantë me mesatare më të ulët, pas miratimit paraprak nga Departamenti përkatës.
3. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 (pesë) vite në specialitetin përkatës (për lëndët klinike);
4. Të zotërojë një gjuhë të huaj perëndimore të certifikuar, preferohet gjuha angleze
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata

### **Kritere preferenciale**



1. Të ketë doktoraturë në fushën përkatëse
2. Të ketë eksperiencë pune
3. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse
4. Të ketë publikime në revista shkencore, konferenca apo pjesëmarrje në kërkime shkencore
5. Të ketë të mbrojtur me dëshmi gjuhën angleze.

### **KRITERET E PUNËSIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK ME KOHË TË PJESSHMË DEPARTAMENTI DDRSHIKIOGJ**

Kandidatët për vendet e punës për personel akademik me kohë të pjesshme në DDRSHIKIOGJ duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të jenë diplomuar sipas degëve ose profilit që aplikojnë, në programe Master Shkencor.
2. Të kenë përfunduar studimet universitare me notë mesatare mbi 8. Nëse nuk ka paraqitje Brenda afatit të aplikantëve me këtë mesatare atëherë mund të pranohen aplikantë me mesatare më të ulët, pas miratimit paraprak nga Departamenti përkatës.
3. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në specialitetin përkatës
4. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata
5. Të ketë nivel të njohjes së gjuhës së huaj, preferohet gjuha angleze

#### **Kriteret e parapëlqyera**

1. Të ketë gradën Doktor ose Titull në fushën përkatëse
2. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie në fushën përkatëse
3. Të ketë publikime dhe pjesëmarrje në aktivitete shkencore
4. Të ketë lejen nga punëdhënësi për tu përfshirë si pedagog i jashtëm, FSHMT

#### **Kriteret për mbikëqyrës klinik ose praktika profesionale**

1. I punësuar në QSUT ose qendra shëndetësore
2. Të ketë përfunduar studimet me notë mesatare mbi 7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse
4. Të jetë i diplomuar në Master i Shkencave ose Master Profesional

**1. Të miratojë nevojat për pedagogë me kohë të pjesshme si më poshtë:**

**- DEPARTAMENTI I LËNDËVE PARAKLINIKE**

<b>Nr.</b>	<b>Lënda</b>	<b>Orë në auditor</b>	<b>Numri i pedagogëve</b>
1	Gjuhë latine	153	4
2	Gjuhë Angleze	510	7
3	Legjislacion	140	2
4	Komunikim profesional	160	2
5	Psikologji e përgjithshme & shëndeti	384	5
6	Psikologji klinike, zhvillimi	100	3
7	Gjuhë shqipe/Gramatikë, Glotologji, Neurolinguistikë	210	3
8	Shkrim akademik	120	2
9	Kimi organike / kimi inorganike	56	1
10	Biologji, Bioteknologji, Biologji molekulare Radiobiologji, Gjenomikë, Gjenetikë	193	5
11	Fiziologji, neurofiziologji	320	4
12	Mikrobiologji	120	3
13	Anatomi	280	4
14	Statistikë mjekësore	150	3
15	Bioetikë	135	1
16	Organizim, menaxhim dhe promovim shëndeti	180	2

**DEPARTAMENTI I DIAGNOSTIKËS, REHABILITIMIT SHËNDETSOR  
INFIRMIERISTIKËS NË KIRURGJI, INFIRMIERISTIKËS NË  
OBSTETRIKË - GJINEKOLOGJI**

Adresa: Rr. e Dibrës, brënda QSU "Nënë Tereza", Tiranë. website: www.fshmt.umt.rash.al;



Nr	Lënda	Profili	Nr. i Pedagogëve
1.	Fizioterapi	Fizioterapist	13
2.	Imazheri	Mjek Imazherist	7
3.	Imazheri	Teknik Imazherie	8
4.	Anatomopatologji	Mjek Anatomopatolog	3
5.	Laborator – Lëndë profesionale	Mjek Laboratori/Teknik Laboratori	10/1
6.	Mikrobiologji e Biolog	Mjek Mikrobiolog	2+2
7.	Mjek Toksikolog		1
8.	Logopedi	Logopedist	8
9.	Logopedi	Ortodontist (Dentist)	1
10	Logopedi	Logoped i specializuar, master në pedagogjinë e specializuar sociale ose në fushën e logopedisë	1
11	Pediatri, Neuropediatri	Mjek Pediatër	3
12	Neurologji	Mjek Neurolog	1
13	Teknika të rehabilitimit në psikiatri	Mjek psikiater	3
14	Biofizikë, Fizikë biomjekësore, Biomekanikë	Fizikant	3
15	Imunologji/Teknika të avancuara të Imunologjisë	Imunolog, Alergolog	3
16	Hemotransfuzion	Mjek Transfuziolog	3

- **Mbikëqyrës klinik** për orët e praktikave klinike që zhvillohen në Qendra shëndetësore dhe në QSUT të diplomave Teknik Imazherie, Teknik Laboratori, Fizioterapi dhe Logopedi

Dega	Numri i mbikëqyrësve klinik
Logopedi	6
Teknike Imazherie	11
Teknik Laboratori	9
Fizioterapi	9



**DEPARTAMENTI I LËNDËVE KLINIKE INFERMIERISTIKËS SË  
PËRGJITHSHME, INFERMIERISTIKËS NË SËMUNDJE TË BRENDSHME,  
PEDIATRI**

	<b>Lënda</b>	<b>Ngarkesa Orë në auditor</b>	<b>Nr. i Pedagogëve</b>
1	Obstetrikë- Gjinekologji	650	10
2	Kirurgji	450	6
3	Pediatri	500	6
4	Sëmundje të Brendshme	600	10
5	Neurologji	400	5
6	Psikiatri	300	5
7	Onkologji	300	4
8	Nutricion Klinik	100	2
9	Vaksinimi	170	2
10	Shëndet Riprodhues	150	3
11	Kirurgji Maksilo-Faciale	50	1
12	Okulistikë	80	2
13	Otorinolaringologji	100	2
14	Ortopedi	50	1
15	Anestezi – Reanimacion	100	1
16	Kujdes Paliativ	250	2
17	Kardiokirurgji	50	1

- **Mbikëqyrës klinik** për orët e praktikave klinike që zhvillohen në Qendra shëndetësore dhe në QSUT të diplomave Infermieri dhe Mami

<b>Dega</b>	<b>Orë praktike profesionale të planifikuara për mbikëqyrës klinik (te konvertuara)</b>	<b>Numri i mbikëqyrësve klinik</b>
<b>Infermieri /Mami</b>	11000	80



Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar Departamentit për lëndën në të cilën do të konkurrojë.
2. Curriculum vitae e detajuar me të gjithë aktivitetin shkencor dhe botues të kandidatit
3. Leje nga punëdhënësi në organizatën ose institucionin ku punon
4. Dokument identifikimi
5. Fotokopje të noteruara të diplomës dhe listës së notave të të gjitha programeve të studimit (Bachelor, Master Shkencor, Doktoraturë).
6. Fotokopje të noteruara të vërtetimit të ekuivalentimit të diplomës nga MAS, si diplomë, listë notash si dhe njohje të gradave për kandidatët që kanë studiuar jashtë shtetit
7. Kopje të noteruara të dëshmimeve të gjuhëve të huaja të mbrojtura (e detyrueshme të paktën një)
8. Kopje të notuar të librezës së punës
9. Vërtetim page, shoqëruar me derdhjen e sigurimeve shoqërore nga qendra e punës
10. Dëshmi penaliteti
11. Dy referenca nga të cilat të paktën njëra të jetë nga një profesor i fakultetit që është diplomuar (dorëzohet vetëm nëse kandidati aplikon për herë të parë)

